



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TAKIMIN E NIVELIT TË LARTË PËR PUNONJËSIT E BARAZISË GJINORE**

*2 maj 2012*

Ministri Nishani,  
Ministri Ksera,  
Zëvendësministre,  
Kryetarë bashkish,  
Zonja dhe zotërinj,  
Mirëmëngjesi!

Është kënaqësi e madhe për mua sot, që në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, t'ju uroj mirëseardhjen në një aktivitet që synon të forcojë më tej mekanizmin e barazisë gjinore në Shqipëri.

Me këtë rast, do të doja të falënderoja ministrat Nishani dhe Ksera për angazhimin e tyre të plotë personal për promovimin e politikave të barazisë gjinore.

Për Prezencën e OSBE-së, promovimi i barazisë gjinore përbën një angazhim vendimtar.

Plan i Veprimit të OSBE-së për Barazinë Gjinore vlerëson se të drejtat e barabarta të burrave dhe grave dhe mbrojtja e të drejtave të tyre të njeriut janë thelbësore për një zhvillim të suksesshëm të njerëzimit: paqe, demokraci e qëndrueshme, zhvillim ekonomik, dhe rrjedhimisht edhe siguri e stabilitet. Kjo është themelore në Shqipëri, në Evropë, në gjithë rajonin e OSBE-së dhe në çdo cep të botës.

Demokracia kërkon kontrollin e popullit. Ajo bazohet te kontrolli i popullit. Kontroll mbi vendimmarrjen dhe cilësinë e të drejtave në ushtrimin e këtij kontrolli. Për qytetarët, kjo shprehet në zgjedhje dhe përmes shoqërisë civile në diskutimet publike.

Gratë dhe burrat duhet të jenë në gjendje të luajnë një rol të plotë në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Kur veprojnë si votues, mund të jetë kështu vërtet. Por a ndodh kështu kur veprojnë si politikanë të zgjedhur? Apo si zyrtarë publikë, kur i shërbejnë komunitetit?

Në qoftë se gratë nuk përfshihen njëjloj në hartimin dhe zbatimin e politikave, legjislationit dhe mekanizmave të zbatimit të tyre në çdo fazë, atëherë sistemet që dalin prej tyre nuk do të jenë plotësisht demokratike.

Gratë përballen vazhdimisht me diskriminimin dhe shpesh shpërfillen ose anashkalohen në formulimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve.

Rezultati për gratë është rrënjësja dhe institucionalizimi i pabarazisë gjinore.

Megjithatë, rreziku që të jenë vetëm gratë ato që flasin për gratë dhe vetëm burrat ata që flasin për burrat, duhet shmangur.

Të dyja palët duhet të flasin për njëra-tjetrën dhe të përfshihen në krijimin e një shoqërie të barabartë.

Përkatesia gjinore duhet marrë parasysh në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave dhe programeve në çdo nivel dhe duhet të përfshijë si gratë, ashtu edhe burrat.

Kjo qasje – integrimi gjinor – është përkufizuar nga OKB-ja si vijon:

“Integrimi i një perspektive gjinore është procesi i vlerësimit të implikimeve që sjell për gratë dhe burrat çdo plan veprimi, duke përfshirë legjislacionin, politikat dhe programet, në çdo fushë dhe në çdo nivel. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore.”

Ministra,  
Miq të nderuar,  
Zonja dhe zotërinj,

Shqipëria po bën përpjekje të rëndësishme për ta integruar përkatësinë gjinore në të gjitha sferat e jetës publike.

Vitet e fundit është parë një forcim i konsiderueshëm i ligjeve dhe politikave që promovojnë barazinë gjinore:

Këto hapa janë ndërmarrë nga disa qeveri njëra pas tjetrës për të mbështetur ecjen përpara të grave.

Pjesa më e madhe e asaj çka është arritur ka kontribuar shumë në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare nga kuadri ligjor i Shqipërisë.

Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri, i miratuar në vitin 2008, parashikonte krijimin e një Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore si organin kryesor monitorues dhe këshillues të shtetit për çështje dhe politika të barazisë gjinore, dhe kërkonte emërimin dhe fuqizimin e punonjësve me kohë të plotë të barazisë gjinore, ose pikave fokale për barazinë gjinore.

Punonjësit e Barazisë Gjinore janë të rëndësishëm sa i përket zhvillimit të politikave dhe programeve të institucioneve të tyre nga këndvështrimi gjinor.

Vitet e fundit kanë treguar rezultate pozitive, duke mundësuar në të njëjtën kohë edhe identifikimin e disa sfidave, si institucionalizimi i posteve të tyre, termat e referencës dhe nevoja për forcimin e kapaciteteve të tyre për përmbushjen e detyrave.

Në katërmëdhjetë ministritë e qeverisë, janë zyrtarisht vetëm dy punonjës të barazisë gjinore me kohë të plotë. Tabloja është e ngjashme edhe nivel vendor.

Shumë është arritur e po arrihet, por shumë mbetet ende për të bërë.

Prezenca e ka mbështetur forcimin e mekanizmave kombëtarë të barazisë gjinore, duke bashkërenduar punën e saj me të tjerë aktorë të interesuar vendas dhe ndërkombëtarë.

Kontributi më i fundit është analiza e situatës, që do të prezantohet sot.

Ky studim konfirmoi disa prej problemeve tashmë të njohura dhe nxori në dritë edhe disa probleme të reja, por për këtë së shpejti do të dëgjojmë më shumë.

Ajo çka është vërtet mbresëlënëse sot është se kemi të pranishëm përfaqësues të të gjitha niveleve.

Integrimi gjinor mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse qeveria, Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore, kryetarët e bashkive dhe punonjësit e barazisë gjinore janë të gjithë pjesë e këtij procesi.

Tani është koha që të finalizohet procesi i emërimit të punonjësve të barazisë gjinore dhe të forcohen lidhjet midis ministrive, Këshillit Kombëtar, kryetarëve të bashkive dhe punonjësve të barazisë gjinore.

Ministra,  
Të nderuar miq,  
Zonja dhe zotërinj,

Në emër të Prezencës së OSBE-së, do të doja t’ju uroja të gjithëve suksese në vazhdimin e punës suaj. Ju faleminderit!